

Plani i Veprimit të Strategjisë së Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare

(2026-2027)

Miratuar me urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. Nr. 57921 date 04.05.2026

Plani dy-vjeçar i veprimit është përgatitur në përputhje me Strategjinë e Përgjithshme të Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare (ADSH) 2023-2027. Ky plan është hartuar për të harmonizuar operacionet doganore me standardet ndërkombëtare, veçanërisht ato të Bashkimit Evropian, një bashkëpunim më të mirë me aktorë të ndryshëm.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: ZHVILLIMI DHE MODERNIZIMI I MËTEJSHËM I LEGJISLACIONIT, PROCEDURAVE DHE PROCESEVE

Ky objektiv fokusohet në përafrimin e legjislacionit dhe procedurave doganore dhe të akcizave me standardet e BE-së, zbatimin e një sistemi garancie gjithëpërfshirëse, futjen e deklaratave para-mbërritjes në e-Tregtinë, zhvillimin e një strategjie pas-zhdoganimit dhe auditimit, vlerësimin dhe rritjen e efektivitetit të pikave të kontrollit kufitar, si dhe paraqitjen e provave të origjinës në mënyrë elektronike. Këto masa janë thelbësore për sigurimin e pajtueshmërisë ligjore, uljen e kohës së përpunimit dhe përshtatjen me peizazhin e zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare.

1.1 Përafrimi i mëtejshëm i Legjislacionit dhe Procedurave Doganore dhe Akcizave

Aktivitete:

1. Përgatitja e projektligjit që ndryshon Kodin Doganor për miratim nga Kuvendi i Shqipërisë, që përfshin rishikimin e legjislacionit ekzistues doganor, analizën për evidentimin e mangesive dhe boshlleqeve në legjislacionin nacional në raport me atë të BE, tabelat e përputhshmërisë, relacionin shpjegues dhe projektligjin.

2. Përgatitja e projektvendimit që ndryshon VKM nr.651 datë 10.11.2017 për miratim nga Këshilli i Ministrave që përfshin rishikimin edispozitave zbatuese të Kodit Doganor,, analizën për evidentimin e mangësive dhe boshlleqevenë raport me dispozitat zbatuese të Kodit Doganor të BE, , tabelat e përputhshmërisë, relacionin shpjegues dhe projektvendimin.

3. Përgatitja e projektligjit që ndryshon ligjin nr.61/2012 "Për Akcizat në RSH" për miratim nga Kuvendi i Shqipërisë që përfshin rishikimin e legjislacionit ekzistues të akcizës, analizën për evidentimin e mangësive dhe boshllëqeve në legjislacionin nacional në raport me atë të BE, tabelat e përputhshmërisë, relacionin shpjegues dhe projektligjin.

4. Përgatitja e projektvendimit që ndryshon VKM nr.612/2012 "Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr.61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë, që përfshin rishikimin e legjislacionit ekzistues të akcizes, analizën për evidentimin e mangësive dhe boshllëqeve në legjislacionin nacional në raport me atë të BE, tabelat e përputhshmërisë, relacionin shpjegues dhe projektvendimin.

5. Përgatitja e projekt-udhëzimeve dhe procedurave bazuar në legjislacionin e ri.

6. Aderimi në Konventën për "Procedurën e Transitit të Përbashkët".

7. Aderimi në Konventën "Mbi thjeshtimin e formaliteteve në tregtinë e mallrave".

Treguesit e Matshëm:

- Raporti i shqyrtimit mbi progresin në përafrimin me legjislacionin dhe standardet e BE-së.
- Kryerja e një rishikimi gjithëpërfshirës të legjislacionit ekzistues doganor dhe të akcizës gjatë procesit të shqyrtimit.

- Identifikimi i boshllëqeve dhe fushave në procedurat që kërkojnë përafrim me standardet e BE-së.

- Miratimi i legjislacionit të ri në Kuvendin e Shqipërisë.

- Përgatitja e projekt-udhëzimeve dhe procedurave bazuar në legjislacionin e ri.

Njësitë Përgjegjëse:

- Departamenti Teknik, Departamenti i Akcizës, Departamenti Operativ Hetimor, Drejtoria e Apelimit, Ankimimeve Doganore dhe Përafrimit me BE

Kuadri Kohor:

- 24 muaj.

1.2 Zbatimi i një Sistemi Gjithëpërfshirës Garancie

Aktivitete:

1.2.1 Zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi garancie gjithëpërfshirëse.

- Zbatimi i plotë i sistemit GUM (Guarantee Management System[1]) dhe integrimi i tij me sistemin Asycuda World.

1.2.2 Zbatimi i garancisë së reduktuar ose përjashtimit nga garancia

- Hartimi dhe miratimi i procedurave për aplikimin e garancisë së reduktuar dhe përjashtimit nga garancia.
- Zbatimi praktik për operatorët ekonomikë të besueshëm.

1.2.3 Lidhja e sistemit të garancisë me programin AEO

- Integrimi i përfitimeve të garancisë me statusin Operator Ekonomik i Autorizuar (AEO).
- Rritja e përfitimeve konkrete për AEO (ulje garancie ose përjashtim, procedura të thjeshtuara).

1.2.4 Ofrimi i trajnimeve për stafin për sistemin e ri të garancisë.

- Trajnimi i stafit për sistemin GUM

1.2.5 Informimi i komunitetit të biznesit mbi përfitimet e sistemit të ri.

[1] Në referencë të VKM Nr.710, dt.26.11.2025 "Për miratimin e Strategjisë për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor Shqiptar, në përputhje me sistemet e informacionit doganor të Bashkimit Evropian, për periudhën 2025–2030 dhe të planit të veprimit".

- Kontributi në aspektin teknik nga strukturat zbatuese.

1.2.6 Rishikimi dhe përditësimi i rregullt i sistemit bazuar në reagimet.

- Mbledhja e opinioneve nga biznesi dhe administrata.
- Rishikimi periodik i procedurave dhe sistemit.

Treguesit e Matshëm:

.

- Numri i operatorëve që përfitojnë garanci të reduktuar / përjashtim
- Numri i operatorëve AEO që përdorin garancinë globale

Njësitë Përgjegjëse:

- Departamenti Teknik/ Drejtoria e Statistikës, Pagesave, Analizës së të Ardhurave dhe Administrimit të Borxhit

Kuadri Kohor:

Zhvillimi projektit të Garancisë Globale do të jetë në dy faza:

- Faza e parë, pritet te filloje implementimi ne sistemin Asycuda World sipas parashikimeve të VKM 921 datë 29.12.2014 (te ndryshuar) per dhenien e garancive nga Sektori Kontrollit Pagesave, te Ardhurave dhe Garancive, i cili administron rregullat dhe procedurat e dhenies se garancise doganore!
- Faza e dytë do të jetë nepermjet sistemit GUM sipas VKM 710 dt.26.11.2026 "Për miratimin e strategjisë për modernizimin e sistemeve doganore dhe përafrimin me BE 2025-2030").

1.3 Prezantimi i Deklaratës Para-mbërritjes/paradaljes në E-Tregti

Aktivitete:

- Zbatimi i Marrëveshjes me shërbimet postare në funksion të e-Tregtisë.
- Integrimi i moduleve të e-tregtisë(E-commerce) dhe deklarates se thjeshtezuar në sistem ne perputhje me piken 4.23 te VKM-se nr.710 date 25.11.2025.
- Implementim te analizes se riskut ne deklarimin e para mberitjes/para daljes (manifest) nepermjet zbatimit te projektit ASYHUB me autoritetet portuale.
- Hartimi i udhëzimeve dhe zhvillimi i trajnimeve për zyrtarët doganorë dhe palët e interesit.
- Vlerësimi i funksionalitetit dhe efikasitetit të moduleve dhe procedurave të reja.

Treguesit e Matshëm:

- Progresi i zbatimit të platformës së e-tregtisë dhe rritja e performances se kontrolleve

Njësitë Përgjegjëse:

- Departamenti Teknik.

Kuadri Kohor:

- 24 muaj.

1.4 Përmirësimi i kontrolleve pas-zhdoganimit

Aktivetete:

1.4.1 Hartimi dhe zbatimi i planit të kontrollit pas-zhdoganimit

Rritja e efektivitetit të kontrolleve përmes përditësimit të metodologjisë së vitit 2024-2025 dhe përpunimit të të dhënave për evidentimin e riskut dhe të dhënave apo informacioneve operative.

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve dhe trajnimeve profesionale te stafit te Drejtorise se Kontrollit Paszhdoganimit.

Përzgjedhja e subjekteve për kontroll do të bazohet në analizën e riskut, indikatorët e performancës së dyshimtë (vlerësimi, origjina, klasifikimi) si dhe integrohet me informacionet operative të marra nga drejtoritë e tjera apo dhe nga degët doganore.

Subjektet për kontroll do të përzgjidhen bazuar në:

- Aktivitet ekonomik me risk të lartë fiskal;
- Analizë risku mbi klasifikimin, origjinën dhe vlerën doganore.
- Volumin e lartë të importeve në regjimet doganore;
- Mospërputhje në mbylljen e regjimeve të posaçme;
- Trasferimin e mallrave nga njeri regjim tek regjimi tjetër ose subjekt tjetër;
- Deklarimin e mbetjeve dhe firove teknologjike;

Zbatimi i kontrolleve të kombinuara: *kontroll dokumentar* (për verifikimin e transaksioneve) dhe *kontroll fizik* (vizita në ambientet e operatorit).

Përcaktimi i grupeve të punës me specialistë të emëruar sipas kompetencave teknike, duke garantuar vazhdimësinë e procesit nga hapja deri në mbylljen e dosjes.

Kryerja e kontrolleve pranë zyrave qëndrore të Drejtorisë ose drejtpërdrejt në ambientet e Operatorëve Ekonomikë (magazina, zyra kontabiliteti) duke përfshirë edhe degët doganore ku kryejnë aktivitet subjektet objekt kontrolli.

Treguesit e Matshëm

- Përqindja e kontrolleve të përfunduara me sukses kundrejt numrit të rasteve të planifikuara mbi bazë risku dhe informacioni operativ.
- Shkalla e përmbushjes së detyrave të lëna brenda afateve të përcaktuara.
- Përqindja e rasteve që rezultojnë me shkelje/rivlerësim, të nisura posaçërisht nga indiciet operative të drejtorive të tjera dhe analiza e riskut.
- Matja e përmirësimit të sjelljes deklarative të subjekteve pas kontrollit.
- Shpërndarja gjeografike e kontrolleve në përputhje me densitetin e operatorëve ekonomikë me risk të lartë.

Njësia Përgjegjëse:

- Drejtoria e Kontrollit Pas-zhdoganimit.

Kuadri Kohor:

- 24 muaj.

1.4.2 Përmirësimi i sistemit për monitorimin dhe raportim të vazhdueshëm:

- Krijimi i një moduli që lejon gjurmimin e çdo rasti kontrolli nga hapja deri në arkivim. Sistemi duhet të raportojë në kohë reale: numrin e kontrolleve në proces, vlerën e rivlerësimit doganor të propozuar, gjobat e vendosura dhe shkallën e mbledhjes së këtyre detyrimeve (compliance monitoring).

- **Treguesit e Matshëm**

  - Gjenerimi automatik i raportit mujor të performancës (pa ndërhyrje manuale).
  - Koha mesatare e mbylljes së një rasti kontrolli (e matur përmes sistemit).
  -

- **Njësia Përgjegjëse:** AKSHI, Drejtoria e Kontrollit Pas-zhdoganimit

- **Kuadri Kohor:**
  - 24 muaj.

1.4.3 Trajnimi i specialistëve për procedurat e reja të kontrollit

- Realizimi i programeve të trajnimit të fokusuara në metodat e kontrollit të librave tregtarë dhe të dhënave financiare të operatorëve

- Trajnimi do të përfshijë modulet mbi analizën e kontratave ndërkombëtare, verifikimin e pagesave bankare (si provë për vlerën) dhe përdorimin e mjeteve digjitale për krahasimin e të dhënave të deklaruara me ato reale të subjektit.

- **Treguesit e Matshëm:**

  - Numri i certifikatave të lëshuara për trajnimin mbi "Procedurat e Kontrollit Pas-zhdoganimit".
  - Realizimi i trajnimeve të specializuara për çdo sektor të drejtorisë.

- **Njësia Përgjegjëse:**

  - Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Kontrollit Pas-zhdoganimit
- **Kuadri Kohor:**
  - 24 muaj.

1.5 Efektiviteti i Pikës së Kontrollit Kufitar

Aktivitete:
- Vlerësimi i i vazhdueshëm i efektivitetit të pikave ekzistuese të kontrollit kufitar.
- Zbatimi i masave për të rritur efektivitetin e këtyre pikave.
- Investimi në infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme.
- Rishikimi dhe përditësimi sistematik i procedurave të pikave të kontrollit kufitar..

Treguesit e Matshëm:

- Përmirësimi i performancës së shërbimit nëpërmjet uljes së kohës së përpunimit në pikat e kontrollit kufitar.

Njësitë Përgjegjëse:

- Departmenti Teknik, Drejtoria e Burimeve Mbështëtëse ,Departamenti Operativ -Hetimor

Kuadri Kohor:

- 24 muaj.

1.6 Përgatitja dhe implementimi gradual i lëshimit dhe pranimit të provave të origjinës preferenciale në mënyrë elektronike, në përputhje me zhvillimet e iniciativës e-PoC të Komisioni Evropian

Aktivitete

- Pjesëmarrja aktive në iniciativën e-PoC të Komisioni Evropian dhe ndjekja e zhvillimeve në nivel BE.
- Zbatimi i Vendimit Nr. 1/2024 në kuadër të Konventa Pan-Euro-Med (PEM) dhe përshtatja e mëtejshme e kuadrit rregullator dhe procedurave kombëtare.
- Përshtatja e sistemeve të TI-së dhe sigurimi i integrimit me sistemin e e-PoC.
- Hartimi i udhëzimeve praktike dhe zbatimi gradual i lëshimit dhe pranimit të provave elektronike të origjinës preferenciale.
- Informimi dhe trajnimi i stafit doganor dhe operatorëve ekonomikë.

Treguesit e Matshëm:

- Rritja e përdorimit të certifikatave EUR.1 elektronike të origjinës preferenciale.

Njësitë Përgjegjëse:

- Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës.

Kuadri Kohor:

- 2026-2027 e në vijim nëpërputhje me zhvillimet e Komisionit Europian.

1.7 Zbatimi i rregullave kalimtare dhe rregullave të ndryshuara të konventës PEM për Rregullat Preferenciale të Origjinës

Aktivitete:

- Miratimi në Kuvendin e Shqipërisë i Vendimit 1/2025 për rishikimin e Protokollit II të MTL-së Shqipëri - Turqi.
- Bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë për kryerjen e procedurave të brendshme dhe notifikimin në KE dhe OBD.
- Përgatitja e udhëzimit përkatës mbi rregullat e origjinës dhe skemën e kumulimit diagonal.
- Informimi i personelit doganor, agjensive doganore dhe operatorëve ekonomikë nëpërmjet përditësimit të faqes web në dy gjuhë si dhe Unionit Dhomave të Tregtisë & Industrisë .

Treguesit e Matshëm:
- Procedurat e zbatuara.

Njësitë Përgjegjëse:
- Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës.

Kuadri Kohor:
- Brenda vitit 2026.

1.8 Dixhitalizimi i procesit të analizimit të mallrave dhe lëshimit të Çertifikatave të klasifikimit tarifor dhe Raport Testimeve (zbatimi i mëtejshëm në sistemin i LIMS)

Aktivitete:
- Implementimi i draftit të dërguar, për nënshkrimin elektronik në sistemin LIMS,.
- Ndërveprimi i sistemit LIMS me sistemin ASYCUDA
- Zbatimi dhe testimi i draftit.
- Informimi dhe trajnimi i stafit.

Treguesit e Matshëm:
- Sistemi i lëshimit të Raport Testimit dhe Çertifikatave të Klasifikimit Tarifor me nënshkrimin elektronik të jetë funksional.
- Ndërveprimi funksional i dy sistemeve

Njësitë Përgjegjëse:
- Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, Sektori i Tarifës dhe Drejtoria e Laboratori Doganor

Kuadri Kohor:
- 12 muaj- 48 muaj në varësi të Projektit te up grade te sistemit ASYCUDA W nga UNCTAD

1.9 Rinovimi i Çertifikatës së Akreditimit të Laboratorit Doganor

Aktivitete:
- Zbatimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë.
- Mirëmbajtja dhe kalibrimi i aparaturave laboratorike.
- Furnizimi i laboratorit me CRM (material referues i çertifikuar, materiale dhe reagentë kimikë.
- Trajnimi kualifikimi i vazhdueshëm i stafit të Laboratorit Doganor.
- Pjesëmarrja në Testet e Zotësise me laboratorë të BE

Treguesit e Matshëm:
- Certifikata e akreditimit e rinovuar.
- Rritja e numrit të treguesve analitikë të akredituar.

Njësitë Përgjegjëse:
- Drejtoria e Laboratorit Doganor.

Kuadri Kohor:
- 12 muaj

1.10 Modernizim i mëtejshëm i Laboratorit Doganor.

Aktivitete:

- Blerja e aparaturave të reja: Gaskromatograf Mas Spectrometer GC FID MS për analizimin e substancave narkotike e psikotrope, Aparatit densimatës automatik për produktet hidrokarburike, Aparat Absorber Atomik për analizën e metaleve të rënda (siguria ushqimore dhe mjedisore), etj.

Treguesit e Matshëm:

- Rritja e numrit të treguesve analitikë për analizimin e substancave narkotike e psikotrope, analiza për sigurinë ushqimore dhe mjedisore.

Njësitë Përgjegjëse:

- Drejtoria e Laboratorit Doganor.

Kuadri Kohor:

- 12- 36 muaj

1.11 Hyrja në regjistrin e deklaruesit.

Aktivitete:

- Përgatitja e akteve nënligjore për zbatim.
- Infomimi dhe trajnim i operatorëve ekonomik dhe stafit doganor.

Treguesit e Matshëm:

- Numri i autorizimeve për të paraqitur një deklaratë doganore duke futur të dhëna në të dhënat e deklaruesit.
- Numri i kontrolleve mbi përpuethshmërinë me deklaratën doganore.

Njësitë Përgjegjëse:

- Drejtoria e Procedurave Doganore.

Kuadri Kohor:

- Vitet 2026-2027.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2:
LEHTËSIMI I TREGTISË DHE ZGJERIMI I BASHKËPUNIMIT

Lehtësimi i tregtisë është në thelb të këtij objektivi, i cili përfshin thjeshtimin e procedurave, zbatimin e konceptit të Operatorit Ekonomik të Autorizuar (OEA), forcimin e bashkëpunimit me agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare, nxitjen e bashkëpunimit doganë-sektori privat dhe respektimin e Marrëveshjes së OBT-së për Lehtësimin e Tregtisë. Këto Aktivitete synojnë të thjeshtojnë proceset doganore, të zvogëlojnë barrierat administrative dhe të krijojnë një "one-stop-shop" në kufirin me vendet fqinje, duke promovuar në fund një mjedis tregtar më efikas dhe transparent.

2. 1 Procedurat e Thjeshtuara dhe Koncepti i OEA

Aktivitete:

- Analiza e procedurave ekzistuese dhe përcaktimi i hapësirave që kërkojnë përmirësim.
- Hartimi dhe implementimi i procedurave të reja të thjeshtuara, duke integruar edhe konceptin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar (OEA)
- Evidentimi i përfitimeve dhe ofrimi i asistencës për operatorët ekonomikë, me synim nxitjen e interesit për përdorimin e procedurave të thjeshtuara dhe përfshirjen në programin OEA.
- Verifikimi i përmbushjes së kushteve dhe dhënia e autorizimeve për kompanitë e reja për përdorimin e procedurave të thjeshtuara, duke përfshirë edhe konceptin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar (OEA).
- Organizim të fushatave të ndërgjegjesimit me grupet e interesit që të promovohen thjeshtime OEA.

Treguesit e Matshëm:

- Përdorimi i procedurave të thjeshtuara nga kompanitë dhe zhvillimi i njohjeve reciproke të OEA-ve në nivel rajonal dhe me BE-në.
- Numri i kompanive të certifikuara si Operator Ekonomik i Autorizuar (OEA).

Njësitë Përgjegjëse:

- Departamenti Teknik

Kuadri Kohor:

- 24 muaj

2. 2 Bashkëpunimi me Agjencitë Kombëtare dhe Ndërkombëtare

Aktivitete:

- Forcimi i partneriteteve me agjencitë kombëtare, shoqatat e industrisë dhe organizatat ndërkombëtare.
- Zhvillimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit (MM) aty ku është e mundur.
- Mbledhja e rregullt në takime të palëve të interesuara për komente.

Treguesit e Matshëm:

- Bashkepunimi me Organizata Ndërkombëtare. (OBD,Banka Botërore, GIZ dhe CEFTA).
- Number of MoUs signed.

Njësitë Përgjegjëse:

- Kabineti,Drejtoria e Integrimit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve, Departamentet ne DPD.

Kuadri Kohor:

- 24 muaj

2. 3 Bashkëpunimi Doganë - Sektori Privat

Aktivitete:

- Identifikimi dhe eliminimi i barrierave administrative që pengojnë bashkëpunimin.
- Përmirësimi i mekanizmave për dialog të vazhdueshëm me sektorin privat.
- Promovimi i transparencës në procedurat doganore.
- Zbatimi i mekanizmave të reagimit për përmirësim të vazhdueshëm.
- Koordinimi me Dhomën Kombëtare të Tregtisë dhe Industrisë, Dhomën Amerikane të Tregetisë dhe me gjërë.

Treguesit e Matshëm:

- Numri i fushatave ndërgjegjësuese për sektorin privat.

Njësitë Përgjegjëse:

- Zyra e DP, Kabineti, Drejtoria e Integrimit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve, Departamenti Teknik.

Kuadri Kohor:

- 24 muaj

2. 4 Zbatimi i Marrëveshjes së OBT-së për Lehtësimin e Tregtisë

Aktivitete:

- Angazhimi aktiv i doganave në Komitetin e Lehtësimit të Tregtisë.
- Zbatimi i planit të veprimit për lehtësimin e tregtisë mbi pajtueshmërinë.
- Rishikimi dhe raportimi i rregullt mbi progresin.
- Bashkëpunimi me palët përkatëse mbi ngritjen e kapaciteteve.

Treguesit e Matshëm:

- Progresi në përmbushjen e kërkesave të Marrëveshjes për Lehtësimin e Tregtisë së OBT-së.

Njësitë Përgjegjëse:

- Departamenti Teknik, Drejtoria e Integrimit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve.

Kuadri Kohor:

- Rishikimi periodik i politikave tregtare mbi baze 5 vjecare.

2.5 Ofrimi i shërbimeve online nga Drejtoria Teknike e Akcizës duke siguruar zbatueshmërinë korrekte të ligjit nga ana e operatorëve.

Aktivitete:

- Shqyrtimi i aplikimeve për vendime favorizuese/shërbime që vijnë online në platformën e-albania.
- Hartimi i autorizimeve dhe përcjellja për miratim.

Treguesit e Matshëm:
- Përgatitja dhe miratimi i vendimeve favorizuese.
- Zbatueshmëria e Ligjit për Akcizat.

Njësitë Përgjegjëse:
- Departamenti i Akcizës, Drejtoria Teknike e Akcizës

Kuadri Kohor:

24 muaj

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3:
KONTRIBUTI PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN

Siguria dhe mbrojtja janë shqetësimet kryesore në operacionet doganore. Zbatimi i një strategjie për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (IPR), një sistem gjithëpërfshirës i menaxhimit të riskut, një ekuilibër midis kontrollit dhe lehtësimit, kontrolleve të zgjeruara në fushën e akcizës dhe masave kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit kontribuojnë në mbrojtjen e interesave kombëtare. Bashkëpunimi me palët e interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare forcon më tej kuadrin e sigurisë.

3.1 Zbatimi i Strategjisë së IPR

Aktivitete:

- Pjesëmarrja aktive në rishikimin dhe përditësimin e strategjisë ekzistuese kombëtare për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (IPR).
- Rritja e bashkëpunimit me sektorin privat për mbrojtjen e IPR.
- Përgatitja e udhëzimeve për procedurat e IPR për zyrtarët doganorë.
- Trajnimi i zyrtarëve doganorë për çështjet e të drejtave të pronësisë intelektuale (IPR).
- Pjesëmarrja në fushata ndërgjegjësuese lidhur me IPR.

3.1.1 Rritja e profesionalizmit dhe eficiencës së burimeve njerëzore në fushën e pronësisë intelektuale.

Masat:

- Organizimi i trajnimeve periodike për stafin e DMPI, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
- Hartimi i moduleve të specializuara për:
- identifikimin e produkteve që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale,
- procedurat e ndalimit dhe sekuestrimit.

3.1.2 Rritja e efektivitetit në identifikimin dhe parandalimin e shkeljeve.

Masat:

- Përditësimi dhe përmirësimi i profileve ekzistuese të riskut bazuar në të dhënat e mbajtësve të të drejtave.
- Krijimi i profileve të reja të riskut për kategori të ndryshme produktesh dhe operatorësh.

3.1.3 Informimi dhe sensibilizimi i aktorëve mbi rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë intelektuale.

Masat:

- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese në bashkëpunim me institucionet ligjzbatuese.
- Informimi i bizneseve mbi të drejtat dhe detyrimet ligjore.

3.1.3 Rritja e koordinimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për luftën kundër shkeljeve.

Masat:

- Intensifikimi i bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese në nivel kombëtar.
- Koordinimi i ngushtë me strukturat e tjera të DPD, veçanërisht DOH.

Treguesit e Matshëm:

- Numri i mbajtësve të të drejtave të IPR.
- Numri i rasteve të trajtuara të shkeljeve të IPR.
- Numri i fushatave ndërgjegjësuese për IPR.
- Rritje e kapaciteteve profesionale dhe përmirësim i cilësisë së zbatimit të ligj.
- Targetim më i saktë i kontrolleve dhe rritje e rasteve të evidentuara.
- Rritje e nivelit të ndërgjegjësimit për mbajtësit e të drejtave dhe konsumatorët.
- -Rritje e efikasitetit në parandalimin, zbulimin të mallrave që mund të shkelin një pronësi intelektuale.
- Rritja e stafit të trajnuar në fushën e çështjeve të pronësisë intelektuale, duke përfshirë të gjitha degët doganore.
- Përditësimi dhe krijimi i profileve të riskut për trajtimin e çështjeve të pronësisë intelektuale.
- Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi çështjet e pronësisë intelektuale.
- Pezullimi i çlirimit të mallrave që dyshohen se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale

Njësitë Përgjegjëse:

- Drejtoria IPR

Kuadri Kohor:

- 24 muaj.

3.2 Përmirësimi i Sistemit Gjithëpërfshirës të Menaxhimit të Riskut

Aktivitete:

3.2.1 Rishikimi i profileve ekzistuese të riskut dhe ndërtimi i profileve të reja me qëllim përmirësimin e cilësisë së përzgjedhjes me risk.

3.2.2 Rishikimi i indikatorëve të riskut për Kanalin Jeshil si dhe rritja e nivelit përzgjedhës të këtij kanali me qëllim lehtësimin e tregtisë së ligjshme;

3.2.3 Reduktimi i kontrolleve fizike dhe dokumentare duke u fokusuar në rastet me risk të lartë, me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe reduktimin e kohës së pritjes për operatorët ekonomikë.

3.2.4 Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë e tjera ligjzbatuese dhe partnerët ndërkombëtarë për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin në menaxhimin e riskut.

3.2.5 Krijimi dhe zbatimi i profileve të përbashkëta të riskut rajonal.

3.2.6 Përmirësimi i Modulit të Selektivitetit në Sistemin Asycuda World si dhe implementimi i këtij moduli në fusha ku ai ende nuk vepron si p.sh., implementimi i Modulit të Selektivitetit në Deklarimin e Thjeshtur;

3.2.7 Përdorimi i mjeteve të reja të teknologjisë si IA për qëllime të analizës së riskut.

Treguesit e Matshëm:

- Niveli i rishikimit të profileve ekzistuese;
- Indikatorë risku të rishikuar për përzgjedhjen në Kanalin Jeshil;
- Niveli i përzgjedhjes në kanalin jeshil;
- Niveli i kontrollit fizik dhe dokumentar;
- Profile të ndërtuara mbi bazën e informacioneve të ardhura nga struktura te tjera brenda dhe jasht DPD-së;
- Kalimi nga Serveri Test në Serverin Qendror i Modulit të Selektivitetit të Deklarimit të Thjeshtuar;
- Testimi i mjeteve të reja të teknologjisë si IA për qëllime të analizës së riskut.
- Shkalla e Automatizimit të Selektivitetit në % e deklaratave të procesuara pa ndërhyrje njerëzore;
- Efikasiteti i Kanalit Jeshil, % e operatorëve (AEO) që kalojnë pa asnjë pengesë;
- Përdorimi i të dhënave para-mbërritjes, % e profileve të krijuara mbi Manifestin (ajror/detar)

Njësitë Përgjegjëse:

- Drejtoria e Analizës dhe Monitorimit të Riskut, Specialisët e Risku lokal në degë doganore, AKSHI.

Kuadri Kohor:

- Në vazhdim e sipër.
-

3.3 Forcimi i kontrollit mbi prodhimin, magazinimin, qarkullimin dhe tregtimin e mallrave te akcizes;

Aktivitete:

3.3.1 Rritja e kontrolleve të bazuara në analizë risku për:

- impiantet e prodhimit/përpunimit;
- magazinat fiskale te stokimit;
- njësitë e tregtimit dhe pikat e shpërndarjes të produkteve te akcizës

3.3.2 Hartimi dhe zbatimi i planeve vjetore të kontrollit të akcizës;

Treguesit e Matshëm:

- Numri i kontrolleve të kryera sipas planit;
- Përqindja e subjekteve të kontrolluara ndaj totalit të subjekteve te akcizes.
- Rritja e te ardhurave nga produktet e akcizës

Njësitë Përgjegjëse:

- Drejtoria e Kontrollit të Akcizave

Kuadri Kohor:

- Në vazhdim e sipër

3.4 Lufta kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

Aktivitete:

3.4.1 Rritja e bashkëpunimit me institucionet financiare dhe agjencitë e zbatimit të ligjit.
3.4.2 Implementim i Rregulloreve të BE nr. 1672/2018 dhe nr. 776/2021, në lidhje me deklarimin e cash-it në kufi.
3.4.3 Rritja e kapaciteteve të degëve doganore kufitare në lidhje me implementimin e Rregulloreve të BE dhe Manualit Udhëzues.

Treguesit e Matshëm:

- Rritja e cilësisë së informacionit dhe diversifikimi i Raporteve të Aktiviteteve të Dyshimtë(RAD) pranë Agjencia e Inteligjencës Financiare).
- Numri i rasteve të zbuluara të pastrimit të parave dhe kundër terrorizmit.
- Krijimi/perditesimi i profileve te riskut ne kuader te luftes kiunder Pastrimit te Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

Njësitë Përgjegjës.e:

- DOH, Drejtoria e Antitrafikut.

Kuadri Kohor:

- Në vazhdim e sipër.

3.5 Kontrolli i Pakove Postare

Aktivitete:

3.5.1 Forcimi i procedurave të kontrollit për pakot postare përmes miratimit te Procedures Standarde te Veprimit per Kontrollin e pakove postare.
3.5.2 Trajnimi i zyrtarëve doganorë për zbulimin e mallrave të ndaluara dhe të rrezikshme në pakot postare.
3.5.3 Përditësimi i vazhdueshëm i profileve të riskut dhe procedurave të kontrollit në përputhje me trendet e reja të trafikimit.

Treguesit e Matshëm:

- Miratimi i P.S.V per Kontrollin e pakove postare
- Numri i pakove të kontrolluara dhe i atyre të identifikuara si me risk.
- Numri i rasteve të zbuluara të shkeljeve përmes pakove postare.

Njësitë Përgjegjëse:

- DOH, Drejtoria Antitrafik.

Kuadri Kohor:

- Në vazhdim e sipër.

3.6 Zbatimi i Legjislacionit të Harmonizuar Jo-doganor në Fushat Sensitive Aktivitete:

3.6.1 Zbatimi i ndryshimeve ligjore dhe akteve nënligjore në kuadër të harmonizimit me legjislacionin evropian për fushat sensitive (trashëgimia kulturore, prekursorët e drogave dhe mallrat dual-use).
3.6.2 Përmirësimi i analizës së riskut përmes krijimit dhe përditësimit të profileve të riskut për zbatimin efektiv të këtij kuadri.
3.6.3 Rritja e kapaciteteve të stafit doganor përmes zhvillimit të trajnimeve të specializuara për zbatimin e legjislacionit përkatës.

Treguesit e Matshëm:

- Numri i amendimeve/akteve të zbatuara;
- Profile risku të krijuara/përditësuara;
- Numri i trajnimeve të zhvilluara për stafin doganor;

Njësitë Përgjegjëse:

- DOH, Drejtoria Antitrafik.

3.7 Lufta kundër Informalitetit dhe Kontrabandës

Aktivitete:

3.7.1 Zbatimi i Planeve Operacionale - Rritja e nivelit të zbulimit dhe goditjes së veprimtarive kontrabandë (kryesisht të mallrave të akcizës) dhe mallrave të paligjshme, përmes kontrolleve efektive të bazuara në analizë risku dhe të dhënave operative.
3.7.2 Rritja e bashkëpunimit operativ me agjensitë e tjera ligjzbatuese dhe partnere ndërkombëtare (Tatime, Police e Shtetit, etj).
3.7.3 Trajnim i strukturave kontrolluese, mbi identifikimin e metodave të sofistikuara të kontrabandës dhe fshehjes së mallrave të paligjshme.

Treguesit e matshëm:

- Efektiviteti i kontrolleve, numri i rasteve të zbuluara dhe mallrave të sekuestruara (kryesisht, të mallrave të akcizës, mallrave të ndaluara dhe cënimit të Pronësisë Intelektuale).
